

D E K R E T
Nr.7459, datë 22.1.1991

**PËR RESPEKTIMIN DHE MBOJTJEN E MONUMENTEVE QË LIDHEN ME
HISTORINË KOMBËTARE DHE TË SIMBOLEVE SHTETËRORE**

Me qëllim që të ndalohet çdo veprim që fyen ndërgjegjen kombëtare dhe është në kundërshtim me unitetin, me traditat e normat morale të popullit; si dhe me qëllim që të mbrohen nga aktet e dhunës e të vandalizmit monumentet e personaliteteve historike e çdo gjë që lidhet me emrin e tyre;

Në mbështetje të nenit 78 të kushtetutës;

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPOËRISË**

V E N D O S I:

1. Përmendoret, bustet dhe memorjalet e çdo lloji kushtuar figurave të ndritura të historisë dhe të kulturës së popullit tonë, heroit kombëtar Gjergj Kastioti- Skënderbeu; patriotëve të mëdhenj të Rilindjes, si vëllezërit Frashëri; luftëtarëve të shquar të Pavarësisë, si Ismail Qemali; personaliteteve të shënuar të luftës për demokraci, si F. S. Noli; udhëheqësit e Luftës Nacionalçlirimtare dhe themeluesit të shtetit të ri shqiptar Enver Hoxha dhe veprimtarëve të tjerë të shquar në jetën shumëshekullore të popullit tonë, janë monumente të paprekshme dhe mbrohen me ligj nga shteti.

2. Mbrohen me ligj edhe lapidarët, pllakat përkujtimore, muzetë, varret e dëshmorëve të rënë për liri e pavarësi, kudo që janë, si dhe flamuri kombëtar, stema e simbole të tjera të Republikës.

3. Çdo veprim që ka për qëllim dëmtimin, prishjen ose ndryshimin e objekteve të mësipërme si dhe çdo fyerje ose veprim që poshtëron figurën e personaliteteve të tilla, dënohen me heqje të lirisë nga 6 muaj deri në 3 vjet.

4. Kur veprat e sipërme kryhen nga një grup i organizuar personash, shoqërohen me akte dhune ose prekin rendin publik, për organizatorët e këtyre grupeve dhe për ata që kryejnë veprën, masa e dënimit dyfishohet.

5. Drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve në qendër e në bazë, të përcaktojnë rregullat e tyre të brendshme për vendosjen, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvendosjen e simboleve të lëvizshme kushtuar figurave të personaliteteve të historisë kombëtare.

6. Kallëzimet për veprat penale të parashikuara në këtë dekret, dërgohen për gjykim drejtpërsëdrejti në gjykatë, pasi të jenë kryer veprimet e para që parashikohen në nenin 127 të Kodit të Procedurës Penale.

7. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË**

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia